

SALI KADRIA

**GJENDJA E RËNDË EKONOMIKO-FINANCIARE
E SHQIPËRISË DHE PËRPJEKJET E QEVERISË SHQIPTARE
PËR SIGURIMIN E NJË KËSHILLTARI FINANCIAR BRITANIK
(1921 –1922)**

Abstrakt:

Artikulli synon t'i paraqesë publikut, gjendjen ekonomiko-financiare të Shqipërisë gjatë viteve 1921-1922, vështirësitë me të cilat përballej qeveria shqiptare për kapërcimin e këtyre problemeve, si dhe përpjekjet e saj për sigurimin e një këshilltari financiar britanik. Autori trajton motivet që shtynë qeverinë shqiptare t'i drejtohej për ndihmë Britanisë së Madhe. Në artikull pasqyrohen diskutimet e zhvilluara, lidhur me kompetencat dhe kufizimet e parashikuara nga qeveria shqiptare për këtë detyrë. Aty jepet qëndrimi që mbajti qeveria britanike ndaj kërkesës shqiptare për ndihmë në këtë drejtim, si dhe argumentet mbi të cilat u mbështet linja e saj politike. Në artikull argumentohet edhe qëndrimi i mbajtur nga Foreign Office ndaj ish diplomatit britanik George Young, i cili u vetofrua për të marrë këtë detyrë me rëndësi në Shqipëri.

Fjalë kyçe:

Shqipëria, Britania e Madhe, qeveria shqiptare, Foreign Office, këshilltari financiar, buxheti i shtetit shqiptar, Dhoma e Thesarit (Treasure of Chambers), gjendja ekonomike dhe financiare

**Problemet ekonomike dhe financiare të Shqipërisë
gjatë vitit 1921, domosdoshmëria e pranisë
së një këshilltari financiar**

Në fillim të vitit 1920 shqiptarët nisën rindërtimin e shtetit të tyre kombëtar. Mirëpo, krahas vështirësive politike të brendshme e të jashtme, drejtuesit e shtetit shqiptar ndeshën vështirësi të pafundme edhe në aspektin ekonomik dhe financiar. Për mbajtjen e administratës dhe të

ushtrisë, ndërtimin e rrugëve dhe të urave, për hapjen e shkollave dhe zhvillimin e burimeve natyrore të vendit, qeverisë shqiptare i duheshin mjete financiare. Mirëpo, Shqipëria në atë periudhë nuk kishte as strukturën ekonomike dhe financiare më elementare, mbi të cilën mund të hidheshin themelet e shtetit shqiptar.¹

Sigurimi i të ardhurave nga ana e shtetit shqiptar u kushtëzua nga mjaft vështirësi e probleme. Një nga plagët më të rënda për ekonominë dhe financat e vendit që u shfaq gjatë vitit 1921 ishte defiçiti i buxhetit të shtetit. Në fillim të vitit 1921, në buxhetin e shtetit shqiptar ishte parashikuar që shpenzimet të ishin nga 18 deri në 19 milion franga ar, ndërsa të ardhurat do të ishin 19 deri në 20 milion franga ar. Në fund të këtij viti, Ministria e Financave zbuloi se ishte krijuar një borxh që arrinte një shumë, më tepër se 5 milion franga ar, e cila nuk kishte hyrë në buxhet.²

Duke parë me kujdes zërat kryesorë buxhetorë të shtetit shqiptar për vitin 1921, konstatohet se pjesën më të madhe të këtij buxheti e zinin shpenzimet që shkonin për Ministrinë e Luftës, Ministrinë e Brendshme dhe për xhandarmërinë shqiptare.* Prandaj, është e qartë se faktori kryesor që ndikoi në thellimin e borxhit të shtetit gjatë këtij viti, ishin operacionet ushtarake që ishte detyruar të ndërmernte qeveria shqiptare për shtypjen e Kryengritjes së Mirditës**, e mbështetur nga qeveria jugosllave. Për këtë arsye, qeveria shqiptare ishte e detyruar që të përmbyste të gjitha përlllogaritjet e mëparshme, duke i zhvendosur mjetet financiare të parashikuara fillimisht për konsolidimin e shtetit, për të plotësuar nevojat e ushtrisë shqiptare. Sipas vlerësimeve të burimeve

¹ Joseph Swire, *Shqipëria - Ngritja e një mbretërie*, përkthyer nga Kujtim Ymeri, Tiranë: Dituria, 2005, f. 310.

² *The National Archives*, London (më tej: TNA), Foreign Office (më tej: FO) 371/ 7332. Raport vjetor mbi Shqipërinë gjatë vitit 1921, hartuar nga ministri britanik H. C. A. Eyres për markezën Curzon të Kedleston, Durrës, 1 maj 1922.

* Në buxhetin e shtetit shqiptar të vitit 1921, shpenzimet kryesore paraqiteshin sipas këtyre zërave: Ministria e Luftës kishte 5.121.800 franga ar; Ministria e Arsimit 2.141.710 franga ar; Ministria e Punëve të Brendshme 2.071.465 franga ar dhe xhandarmëria 2.846.940 franga ar.

** Kryengritja e Mirditës filloi në korrik të vitit 1921 dhe drejtohej kundër qeverisë shqiptare. Më 17 korrik, nga qyteti i Prizrenit, Marka Gjoni shpalli krijimin e “Republikës së Mirditës”. Prapa kësaj lëvizjeje kryengritëse qëndronte shteti jugosllav, i cili synonte aneksimin e Shqipërisë së Veriut. Në fund të nëntorit 1921, A. Zogu arriti t’i jepte fund Kryengritjes së Mirditës.

britanike, agresioni serb i vitit 1921 shkaktoi çrregullimin e financave të Shqipërisë, duke u shoqëruar me një shtesë prej 1 000 000 fr. ar në deficitin e buxhetit të shtetit, duke e çuar borxhin e Shqipërisë në rreth 7 000 000 fr. ar. Prandaj, përfaqësuesi britanik në Lidhjen e Kombeve, H.Fisher, deklaroi se sulmi i padrejtë dhe i paprovokuar jugosllav i kishte kushtuar thesarit të Shqipërisë, 7 milion franga ari, pa llogaritur shkatërrimet e pronave të shtetasve shqiptarë. Prandaj, qeveria shqiptare rezervonte të drejtën që të përlogaritej masa e dëmit për këto prona si dhe të kërkonte dëmshpërbim.³

Faktor tjetër që ndikoi në përkeqësimin e gjendjes së buxhetit të shtetit shqiptar, ishin vështirësitë serioze që ndeshi qeveria shqiptare në mbledhjen e të ardhurave të parashikuara në disa krahina të vendit. Gjithashtu, ndikoi edhe mbyllja e kufirit me Shqipërinë nga Greqia, e cila erdhi si një kundërpërgjigje nga qeveria greke ndaj dëbimit të mitropolitit grek të Korçës nga ana e qeverisë shqiptare.⁴

Në thellimin e deficitit të shtetit shqiptar ndikuan edhe shpërdorimet dhe abuzimet e shumta me detyrën të zyrtarëve që merreshin me financat e shtetit, duke filluar nga Ministria e Financave deri në rangjet më të ulëta të administratës që merrej me financat si dhe mungesa e përvojës nga ana e tyre. Me shpresën se do të arrihej të sigurohej një ndihmë financiare nga jashtë, qeveritë shqiptare të kësaj kohe tejkaluan vazhdimisht buxhetin e miratuar nga Parlamenti Shqiptar. Këto veprime krijuan një deficit të madh në bilancin e shtetit, i cili gjatë vitit 1922 arriti në shifrën 1 753 365 fr. ar.⁵ Vështirësia shtoej më shumë për faktin se shifrat përfundimtare të buxhetit të shtetit të rishikuara për vitin e ardhshëm, nuk jepnin ndonjë perspektivë më të mirë. Këta faktorë, të marrë së bashku, kishin krijuar një gjendje aq të rëndë për thesarin e shtetit shqiptar, sa mendohej se gjatë vitit 1922 qeveria do ta kishte të vështirë të mblidhte taksat e të ardhurat e planifikuara për të hyrë në

³ TNA, FO 371/ 7328. "An Albanian Republic - Ahmed Bey as President", in *Morning Post*, 3 October 1922, shkruar nga korrespondenti në Beograd; J. Swire, *Shqipëria - Ngritja e një mbretërie...*, f. 298.

⁴ TNA, FO 371/ 7328, "An Albanian Republic ...", in *Morning Post*, 3 October 1922, shkruar nga korrespondenti në Beograd.

⁵ Teki Selenica, *Shqipëria më 1927*, Tiranë: Shtypshkronja Tirana, 1928, f. XLIII-XLIV.

buxhetin e shtetit.⁶ Gazeta “Drita” në Gjirokastrë shkruante se në politikën ekonomike të qeverisë shqiptare, vërehej “një sëmundje e keqe, e cila rezikon jetën t’onë ekonomike kombëtare”.⁷ Kjo lidhej me taksat e larta që rëndonin shumë mbi klasën e varfër, e cila i nënshtrohej thelorive jashtë fuqisë së saj për mbushjen e deficitit të buxhetit të shtetit. Për këtë arsye, kjo gazetë bënte thirrje që taksat shtetërore duhet të ishin në përputhje me fuqinë financiare të popullit.⁸

Gjendja ekonomike dhe financiare e shqiptarëve u rëndua edhe për shkak të bilancit negativ të tregtisë me jashtë të Shqipërisë. Gjatë vitit 1921, vlera e importeve kishte pësuar një rritje të ndjeshme krahasuar me atë të eksporteve shqiptare. Shqiptarët eksportuan 2 189 791 fr. ar dhe importonin rreth 18 235 791 fr.ar.⁹ Për shkak të bilancit negativ tregtar të Shqipërisë, në fillim të viteve 1920 filloi importimi i ushqimeve nga jashtë. Deficiti tregtar u shoqërua edhe me një plagë tjetër, e cila kishte të bënte me pakësimin e rezervave të arit brenda vendit. Këto shkaktuan kufizimin e kapitalit qarkullues dhe pakësimin e të ardhurave në buxhetin e shtetit.¹⁰ Kjo solli krijimin e një deficiti buxhetor i cili, gjithnjë e më shumë, u bë një “plagë tipike” e arkës së shtetit. Mungesa e të ardhurave në arkën e shtetit, shkaktonte vonesa në dhënien e pagave të nëpunësve, por edhe në realizimin e pagesave të tjera nga ana e shtetit shqiptar.¹¹ Prandaj, qeveria e Xhafer Ypit, e cila ushtroi veprimtarinë e saj, nga data 24 dhjetor 1921 deri më 2 dhjetor 1922, vendosi të ndiqte një politikë të rreptë kursimi. Për të kompensuar bilancin e pafavorshëm tregtar dhe për të ruajtur rezervat e arit brenda vendit, u vendos më 5 shkurt 1922 një tarifë e lartë doganore.¹²

Një plagë tjetër e madhe për ekonominë dhe financat e Shqipërisë ishte mungesa e monedhës kombëtare. Prania e disa llojeve të monedhave

⁶ TNA, FO 371/ 7332. Raport vjetor mbi Shqipërinë gjatë vitit 1921, hartuar nga ministri britanik H. C. A. Eyres për markezsin Curzon të Kedleston, Durrës, 1 maj 1922.

⁷ “Taksat e Shtetit Civil”, në *Drita*, nr. 86-18, Gjirokastrë, 25 qershor 1922, f. 1.

⁸ *Po aty*.

⁹ Lorenzo Viezzoli S. J., *Shqypnija – Njoftime gjeografike shtetistike – administrative*, ribotim anastatik i Dorës V të plotsueme e të ndreqme, Lezhë: Gjergj Fishta, 2014, f. 153.

¹⁰ *Dielli*, nr. 2509 – (52), Boston Mass., 30 gusht 1922, f. 3.

¹¹ Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri 1897-1942 (Kujtime dhe vlerësime historike)*, përgatiti për botim Marenglen Verli, botim i dytë, Tiranë: Neraida, 2000, f. 288-289.

¹² J. Swire, *Shqipëria - Ngritja e një mbretërie...*, f. 311.

të huaja në vend, kishte shkaktuar një konfuzion në ekonominë e vendit, humbje të tregtarëve për shkak të zhvlerësimeve të papritura të kursit të këmbimit të këtyre monedhave, si dhe humbje të pasurisë kombëtare nga rrjedhja e rezervave të arit të Shqipërisë në tregtinë e saj me jashtë.¹³

Meqenëse në vend qarkullonin monedha të ndryshme të huaja, më 25 qershor 1921, qeveria shqiptare vendosi që nxjerrja e të ardhurave shtetërore të bëhej mbi bazën e frangut ar. Sipas këtij kursi, sterlina angleze do të këmbehej me 25 fr. ar, lira turke me 22 fr. ar, dollari amerikan me 5 fr. ar, marka gjermane me 1.15 fr. ar dhe napoloni francez me 20 fr. ar.¹⁴ Gjithashtu, më 16 mars 1922, Parlamenti Shqiptar kishte miratuar ligjin “Mbi prerjen e kartëmonedhës kombëtare”, Sipas këtij ligji, qeveria autorizojë të priste 3 milion fr. ar kartëmonedhë, të emërtuara “Lekë”.¹⁵ Ligji i datës 27 nëntor 1921, përcaktonte kurset e këmbimit të frangut ar me liritën italiane, dhrahminë greke, koronën austriake dhe frangun francez. Gjatë vitit 1921, megjithëse ende pa një bankë dhe monedhë kombëtare, qeveria shqiptare filloi të ndërhynte në rregullimin e kurseve të këmbimit bazuar në frangun ar të unionit Monetar Latin.¹⁶ Ligji për prerjen e kartëmonedhës shqiptare nuk u zbatua për shkak se qeveria shqiptare u përpoq të hynte në marrëveshje me grupe financiare të huaja për sigurimin e një huaje dhe për krijimin e një banke në Shqipëri.¹⁷

Mungesa e një banke në Shqipëri ishte një mangësi e madhe për zhvillimin ekonomik dhe financiar të vendit. Krijimi i një banke kombëtare, tashmë ishte një domosdoshmëri, edhe për faktin se kapitali i huaj kishte filluar të depërtonte në ekonominë e vendit, kryesisht në sektorët e bujqësisë, pyjeve, minierave dhe në rrjetin e transportit.¹⁸ Për këtë arsye, gazeta “Koha” e Korçës shkruante se “çështja më me rëndësi

¹³ S. Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri...*, f. 290-291.

¹⁴ Haxhi Shkoza, *Financat e Shqipërisë 1839-1934*, Tiranë: Nikaj, 1935, f. 213-214; Valentina Duka, *Qytetet e Shqipërisë në vitet 1912-1924*, Tiranë: Toena, 1997, f. 80.

¹⁵ *Bisedimet e Këshillit Kombëtar*, viti 1922, Tiranë: Nikaj, f. 276-284.

¹⁶ *Monetary policy in Albania: from the past to the present*, Bank of Albania's 10th International Conference, 26 October 2012, published by Bank of Albania, Tiranë: 2012, f. 51.

¹⁷ T. Selenica, *Shqipëria më 1927...*, f. XLIII-XLIV.

¹⁸ Veniamin Toçi, *Ndërrhyrja e kapitalit të huaj në Shqipëri dhe qëndrimi i qarqeve demokratike, 1921-1925*, Tiranë: Mihal Duri, 1974, f. 100.

për shtetin tonë, është themelimi i një banke kombëtare”¹⁹. Krijimi i një banke emetuese ishte i vështirë, sepse bilanci i tregtisë së vendit kishte krijuar një deficit të madh financiar, i cili nuk lejonte krijimin e një stabiliteti për kartëmonedhën.²⁰

Duke parë rëndësinë e krijimit të bankës, më 16 maj 1921, Parlamenti Shqiptar i propozoi qeverisë marrjen e masave për krijimin e saj. Për këtë qëllim, u ngrit një komision i përbërë nga dy deputetë dhe nga ministri i Financave. Komisioni u ngarkua me detyrën e krijimit të Bankës Kombëtare me të drejtë emetimi të kartëmonedhave, duke marrë për bazë projektin austro-italian të paraqitur në vitin 1913 ose duke u mbështetur në projektin e propozuar nga firma shkodrane “Daragjati”. Megjithatë komisioni shkoi për këtë problem në Itali, hyri në marrëveshje edhe me firmën e mësipërme, përpjekjet e tij nuk dhanë rezultate, ndërsa firma “Daragjati” u tërhoq nga ky projekt.²¹

Qeveritë shqiptare hynë në bisedime me shoqëri anonime të huaja si shoqëria “Banque du Brabant” në Bruksel, “Société Nationale de Banque de Change”, shoqëria franceze “Raimon et Cie – Paris”. Kushtet e ofruara prej tyre nuk ishin të përshtatshme për krijimin e një banke kombëtare²². Ministri i Financave, Kol Thaçi u konsultua me dy ekspertë të paanshëm në lidhje me “Banque du Brabant”, por ata ngurruan të jepnin një mendim të prerë, me argumentin se nuk kishin të dhëna mbi gjendjen e vërtetë të ekonomisë shqiptare.²³

Gjatë vitit 1921, qeveria shqiptare arriti në përfundimin se, për kapërcimin e problemeve të mëdha infrastrukturore, ekonomike dhe financiare që kishte vendi, në kushtet kur Shqipërisë i mungonin specialistët e këtyre fushave, duhej të merreshin ekspertë të huaj në shërbimin e saj. Në përmirësimin e rrjetit të rrugëve, Ministria e Punëve Botore vendosi të angazhonte inxhinierë austriakë, hungarezë dhe italianë.²⁴ Për këtë qëllim, ministri i Punëve Botore, Mehdi Frashëri,

¹⁹ *Koha*, nr. 72, Korçë, 11 mars 1921, f. 2; V. Duka, *Qytetet e Shqipërisë në vitet 1912-1924...*, f. 79.

²⁰ S. Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri...*, f. 291.

²¹ H. Shkoza, *Financat e Shqipërisë 1839-1934...*, f. 780; V. Duka, *Qytetet e Shqipërisë në vitet 1912-1924...*, f. 79.

²² H. Shkoza, *Financat e Shqipërisë 1839-1934...*, f. 781-782; V. Duka, *Qytetet e Shqipërisë në vitet 1912-1924...*, f. 79.

²³ S. Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri...*, f. 291.

²⁴ J. Swire, *Shqipëria - Ngritja e një mbretërie...*, f. 311.

shkoi në Itali dhe Austri për të kërkuar disa ekspertë për Shqipërinë. Ai arriti një marrëveshje me një grup prej 24 inxhinierësh, nga të cilët 12 ishin italianë, ndërsa pjesa tjetër ishin austriakë. Grupi i ekspertëve arriti në Shqipëri në muajin nëntor 1921. Mirëpo, që në fillim u vu re se pagat e tyre po vonoheshin, për mungesë të fondeve. Për shkak të krizave politike, shumica e tyre ende nuk ishte punësuar nga qeveria shqiptare. Ndërkohë, disa ekspertëve të cilëve u ishte besuar studimi i projekteve, u ishte thënë se qeveria nuk ishte e gatshme për të përballuar çdo lloj shpenzimi.²⁵

Ministri britanik H. C. Eyres informonte Londrën se, pavarësisht notave optimiste që shprehte qeveria shqiptare në lidhje me veprimet financiare që mund të bëheshin gjatë vitit të ardhshëm, ai mendonte se këto lëvizje nuk mund të ishin aq shpresëdhënëse, pasi ato mbështeteshin kryesisht në rritjen e konsiderueshme të detyrimeve që duhej të paguanin qytetarët në doganat shqiptare. Qeveria kishte vendosur taksa mbi shumë artikuj, të cilët mund të prodhoheshin në Shqipëri si dhe mjaft detyrime të rënda për mjaft produkte, të cilat ajo i konsideronte si artikuj luksi, pasi shqiptarët mund të jetonin edhe pa ato. Ai theksonte se politika doganore e qeverisë ishte e veçantë, por ajo mbështetej në argumente pak të besueshme.²⁶

Gjithashtu, qeveria shqiptare shpresonte se përmirësimi i administratës, por sipas këndvështrimit të Eyres, kjo kishte pak mundësi të ndodhte, nëse mbahej parasysh gjendja politike brenda vendit, do të sillte në buxhet rreth dy herë më shumë të ardhura se më parë nga taksat mbi tokën dhe nga taksa e parashikuar për bagëtitë e imta. Në kushtet e mungesës së statistikave financiare në vend, me të vërtetë ishte shumë e vështirë që të arrihej ndonjë përmirësim apo të bëhej një parashikim i saktë dhe koherent në lidhje me buxhetin e ardhshëm.²⁷

Eyres mendonte se një pjesë e shqiptarëve, veçanërisht në Shqipërinë e Veriut dhe atë të Mesme, nuk punonin sa kishin mundësi. Prandaj, ky problem do t'u sillte telashe ekonomisë familjare dhe financave të vendit, përderisa nuk prodhohej, por vetëm importohet nga

²⁵ TNA, FO 371/ 7328. Heathcote-Smith për markezin Curzon të Kedleston, Durrës, 14 janar 1922.

²⁶ Po aty, FO 371/ 7332. Raport vjetor mbi Shqipërinë gjatë vitit 1921, hartuar nga ministri britanik H. C. A. Eyres për markezin Curzon të Kedleston, Durrës, 1 maj 1922.

²⁷ Po aty.

ana e Shqipërisë. Për këtë arsye, drejtuesit e qeverisë justifikonin vendosjen e taksave për produkte të ndryshme dhe kryesisht të luksit, me argumentin se nuk kishte metodë tjetër që mund ta detyronte popullsinë që të punonte më shumë. Në këndvështrimin e Eyres, në të gjitha rastet e shqyrtuara, dukej se për disa vite nuk kishte të ngjarë të siguroheshin të ardhura të konsiderueshme, të cilat mund të vinin nga taksimi i drejtpërdrejtë ose jo i drejtpërdrejtë. Ai mendonte se burimi kryesor i të ardhurave për qeverinë shqiptare kishte më tepër mundësi që të vinte nga kompanitë e dhëna me koncesion. Një propozim tjetër, ishte marrja e një huaje nga qeveria shqiptare tek qeveri apo kompani të huaja, me garancinë e dhënies së disa koncesioneve, të cilat ende nuk ishin specifikuar. Gjithashtu, shpresohej se, Lidhja e Kombeve mund të ndërmerre hapat e duhura, për të lehtësuar vështirësitë financiare me të cilat po përballlej Shqipëria. Kishte shumë mundësi që ndonjë ofertë e arsyeshme mund të vinte edhe nga ndonjë kompani amerikane ose angleze gjatë vitit të ardhshëm, e cila mund të nxitej nga qeveria shqiptare, përderisa ajo mendonte se zgjidhja e vështirësive të shtetit shqiptar dhe krijimi i një administrate financiare të rregullt, do të mund të arrihej më lehtë përmes mjeteve të tilla.²⁸

Motivet që e shtynë qeverinë shqiptare t'i kërkonte ndihmë Britanisë së Madhe

Qeveria shqiptare iu drejtua për mbështetje Britanisë së Madhe, jo vetëm se ajo ishte fuqia më e rëndësishme politike e kohës dhe një nga fuqitë më të mëdha ekonomike dhe financiare në botë, por edhe për shkak të ndihmës dhe mbështetjes së një grupi përfaqësuesish britanikë ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve në disa raste gjatë viteve 1920-1921, të cilat po i rendisim në vijim.

Më 17 dhjetor 1920, falë mbështetjes që i dhanë çështjes shqiptare, përfaqësuesit britanikë të Afrikës së Jugut, lordit Robert Cecil, atij të Kanadasë N.W. Rowell dhe përfaqësuesit të Indisë, Ali Imam, u arrit pranimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve.²⁹

²⁸ *Po aty.*

²⁹ “Si u pranua Shqipëria në Ligen e Kombeve”, *Drita*, nr. 39, Gjirokastrë, 17 mars 1921, f. 3; “Në Kuvendin e Ligës së Kombeve”, *Drita*, nr. 41, Gjirokastrë, 3 prill 1921, f. 2-3; S. Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri...*, f. 177; Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926*, Tiranë: Dudaj, 2010, f. 319.

Në vjeshtën e vitit 1921, qeveria britanike mbajti një qëndrim të vendosur kundër agresionit jugosllav në Shqipëri. Në fillim të nëntorit të këtij viti, kryeministri britanik kërcënoi qeverinë jugosllave se, nëse ajo nuk tërhiqte forcat ushtarake nga territori i Shqipërisë, ky akt do të konsiderohej si “agresion” dhe Britania e Madhe do t’i kërkonte Lidhjes së Kombeve zbatimin e sanksioneve që parashikonte konventa e kësaj organizate ndërkombëtare. Falë këmbënguljes së Britanisë së Madhe, qeveria jugosllave për pak sa nuk u paraqit në bankën e të akuzuarve si shtet agresor, që kishte dhunuar këtë konventë.³⁰ Vetëm pas presionit të qeverisë britanike, Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene u detyrua të tërhiqte trupat e saj nga brendësia e territorit të shtetit shqiptar.

Britania e Madhe ishte ndër shtetet e para që njohu qeverinë shqiptare. Më 7 nëntor 1921, lordi Curzon i dërgoi një telegram përfaqësuesit britanik në Shqipëri, Eyres, ku i kërkohej që të informonte qeverinë shqiptare se, mbështetur në vendimin e Konferencës së Ambasadorëve në Paris lidhur me kufijtë e Shqipërisë, qeveria britanike njohte qeverinë shqiptare si qeveri *de jure* dhe *de facto* të të gjithë Shqipërisë.³¹ Më 24 janar 1922, Eyres i paraqiti letrat kredenciale qeverisë shqiptare si ministër i Britanisë së Madhe në Shqipëri, ndërsa më 28 mars 1922, diplomati shqiptar Mehmet Konica, i paraqiti qeverisë britanike letrat kredenciale si ministër i Shqipërisë në Londër.³²

Krahas interesave politike dhe gjeostrategjike që kishte qeveria britanike për Shqipërinë në kuadër të rajonit të Ballkanit dhe të Mesdheut, pas vitit 1920, ajo filloi të shfaqte hapur interesat e saj ekonomike për këtë vend. Elita politike shqiptare kishte kuptuar se, për arsytet e lartpërmendura, qeveria britanike synonte ruajtjen e stabilitetit politik të Shqipërisë. Më 20 mars 1920, Foreign Office kishte dërguar H.C.A. Eyres me një “mision të veçantë” në Shqipëri. Ai u kishte bërë të ditur rrethëve politike në Tiranë, që Britania e Madhe ishte e gatshme të siguronte pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, në qoftë se

³⁰ Sali Kadria, “Raportet e Britanisë së Madhe me Shqipërinë gjatë viteve 1920-1922”, *Studime historike*, nr. 3-4, 2017, Tiranë: 2018, f. 93.

³¹ TNA, FO 371/5733. Telegram urgjent i Foreign Office për H. C. A. Eyres në Durrës, FO, 7 nëntor 1921.

³² *Po aty*, FO 371/ 5725. Notë e Foreign Office për të Ngarkuarin me Punë të Francës në Londër, FO, 13 janar 1921; J. Swire, *Shqipëria - Ngritja e një mbretërie...*, f. 274; Pranvera Teli (Dibra), *Shqipëria dhe diplomacia angleze 1919-1927*, Tiranë: Ada, 2006, f. 200.

qeveria shqiptare do t'i premtonte dhënien e monopolit të koncesionit të naftës, kompanisë britanike "Anglo-Persian Oil". Qeveria shqiptare e kishte pranuar këtë propozim.³³

Në pranverë të vitit 1920, Harold W. Temperley, atashe ushtarak në legatën britanike në Beograd, u dërgua me një "mision të veçantë" në Shqipëri. Qeveria shqiptare i kishte kërkuar Temperley-t, të ndërhynte pranë qeverisë britanike, për nxitjen e ndonjë banke britanike që të operonte në Shqipëri. Drejtuesit e qeverisë shqiptare kishin deklaruar se, shqiptarët mirëprisnin kompanitë britanike dhe se ia kishin besuar të ardhmen e tyre Britanisë së Madhe.³⁴

Në fillim të vitit 1921, diplomatët britanikë në Shqipëri mendonin se për shkak të mungesës së pranisë ekonomike dhe financiare të Britanisë së Madhe në Shqipëri, vendi i saj mund të zihej nga Franca, Italia apo ndonjë shtet tjetër. Në mënyrë të tërthortë, diplomatët britanikë njoftonin se, politikan i francez Justin Godard kishte kërkuar lehtësi ndaj kompanive franceze, për ngritjen e një banke në Shqipëri.³⁵ Edhe ministri britanik në Beograd, Alban Young, informonte Londrën se ekzistonte mundësia e hapjes së një banke serbo-shqiptare, me një kapital prej 10 milion dinarë, e institucionalizuar në Cetinë nga një qytetar malazez me emrin Zuber, ndërkohë që Korporata Tregtare Britanike ishte agjente e kësaj banke në Beograd.³⁶

Në fillim të muajit janar 1922, në Shqipëri kishte ardhur Travers, i cili ishte përfaqësuesi i grupit financiar francez nga Parisi, që kishte lidhje italo-britanike. Sipas tij, ky grup financiar synonte të investonte për ngritjen e një banke në Shqipëri, me një kapital fillestar financiar prej 6 milion franga franceze, në të cilën pjesa e aksioneve franceze do të ishte më e madhja. Mendohej se kjo bankë do të hapte zyrën e saj kryesore në Tiranë dhe më tej do të vijonte me hapjen e degëve të saj në Shkodër, Durrës dhe Vlorë. Ndër vështirësitë kryesore që pritej të ndeshte një bankë kombëtare në Shqipëri ishin: vështirësitë e karakterit politik ndërkombëtar; ndërhyrjet dhe zvarritjet e pafundme nga ana e shtetit

³³ William Bland - Ian Price, *A tangled web. A history of Anglo-American relations with Albania 1912-1955*, Albanian Friendship Society of Southern California, London: 1986, f. 13; P. Teli (Dibra), *Shqipëria dhe diplomacia angleze...*, f. 131.

³⁴ P. Teli (Dibra), *Shqipëria dhe diplomacia angleze...*, f. 199.

³⁵ TNA, FO 371/ 7331. H. C. Eyres për markezën Curzon të Kedleston, Durrës, 15 qershor 1922.

³⁶ Po aty, FO 371/ 7331. Sir Alban Young për Earl Balfour, Beograd, 15 qershor 1922.

shqiptar; kundërshtimin nga ana e popullsisë shqiptare, e mësuar me monedha ari dhe argjendi, për të pranuar përdorimin e një bankënote shtetërore të emetuar nga ana e kësaj banke. Të gjitha këto pengesa së bashku do të sillnin vështirësi të mëdha në operacionet financiare të kësaj banke.

Krijimi i një banke në Shqipëri krijonte mundësinë e kryerjes së operacioneve financiare në fushën e këmbimit valutor. Biznesi i këmbimit valutor ishte i favorshëm për shkak të normës së lartë të fitimit; mungesës së institucioneve të këmbimit valutor në Shqipëri; pranisë së monedhave të shumta të huaja në vend; remitançave të konsiderueshme vjetore që dërgonin emigrantët shqiptarë në SHBA, të cilat çdo vit arrinin mesatarisht në rreth dy milion dollarë, si dhe nevojës së madhe për këmbim nga masa e emigrantëve shqiptarë, që synonte të emigronte drejt vendeve perëndimore. Banka që parashikohej të ngrihej në Shqipëri, mendohej të ishte një biznes i kombinuar, i cili mund të jepte kredi, të kryente shkëmbim valutor, të realizonte operacione bankare, të bënte hipotekim të pasurive të patundshme, ndërkohë që më vonë, mund të kryente investime në sektorin e industrisë.³⁷

Me sa duket, diplomatët britanikë kishin ndërhyrë pranë qeverisë shqiptare për të penguar praninë e një banke franceze në Shqipëri. Diplomati Heathcote-Smith shprehej se, pavarësisht optimizmit të bankierit francez, gjatë një bisede që kishte zhvilluar me kryeministrin shqiptar mbi këtë çështje, ai ishte shprehur se qeveria shqiptare do të bënte të pamundurën për të nxjerrë pengesa dhe vështirësi për hapjen e këtij institucioni bankar.³⁸

Kërkesa e qeverisë shqiptare për caktimin e një eksperti financiar britanik dhe qëndrimi i qeverisë britanike

Qeveria e Xhafer Ypit kishte arritur në mendimin se, përgatitja apo specializimi i ekspertëve shqiptarë jashtë vendit, kërkonte kohë, fonde dhe bursa të veçanta. Mirëpo, ata e kuptonin se, edhe marrja e ekspertëve të huaj në Shqipëri, ishte një akt, i cili ishte jo vetëm i kushtueshëm për financat e vendit, por edhe praktikisht i vështirë, pasi ekspertët dhe

³⁷ *Po aty*, FO 371/ 7330. Heathcote-Smith për markezin Curzon të Kedleston, Durrës, 17 janar 1922.

³⁸ *Po aty*.

specialistët e aftë e të përgatitur, ishin gjithnjë të kërkuar në vendet e tyre.³⁹

Përballë vështirësive dhe problemeve të shumta me të cilat ndeshej Shqipëria, drejtuesit e qeverisë shqiptare arritën në përfundimin se, në rrethanat në të cilat ndodhej vendi, çështje parësore për interesat kombëtare, ishte zgjidhja e problemeve financiare. Ata mendonin se hapi i parë në këtë drejtim, ishte gjetja e një këshilltari të aftë financiar. Për këtë qëllim, ata synonin t'i drejtoheshin për ndihmë qeverisë britanike. Me këtë lëvizje, qeveria shqiptare shpresonte të zgjidhte njëherësh disa probleme, me të cilat ndeshej Shqipëria e kësaj periudhe.

Përpjekjet e Shqipërisë për të ftuar organizatorë të huaj e kishin zanafillën në tetor të vitit 1921, kur qeveria e Pandeli Evangjelit deklaroi në parlament se ajo synonte të ftonte këshilltarë të huaj në disa dikastere të saj. Megjithëse për këtë qëndrim, qeveria e P. Evangjelit ishte fajësuar nga disa segmente të politikës shqiptare, qeveria e Xh. Ypit vijoi procedurën e filluar më herët, duke miratuar ligjin, i cili parashikonte të ftonte këshilltarë të huaj në Shqipëri.⁴⁰

Në mesin e muajit janar 1922, ministri “ad interim” i Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Spiro G. Koleka i drejtoi një notë zyrtare legatës britanike në Durrës, përmes së cilës kërkohej një këshilltar financiar nga Britania e Madhe. Dëshira e qeverisë shqiptare për t’ia besuar detyrën e organizimit të financave të shtetit shqiptar një eksperti britanik buronte nga fakti se, Britania e Madhe nuk kishte interesa të drejtpërdrejta në Shqipëri.⁴¹ Kërkesa e Shqipërisë u bë menjëherë pas njohjes zyrtare të qeverisë shqiptare nga qeveria britanike.⁴² Me sa duket, këtë kërkesë duhet ta kenë nxitur përfaqësuesit e legatës britanike në Shqipëri.

Gazeta “Koha” që botohej në Korçë shkruante se vendimi i qeverisë shqiptare për të ftuar organizatorë të huaj për çdo ministri ishte një nga veprat më me rëndësi. Ky vendim ishte pritur me gëzim nga ana e popullit, i cili besonte se përmes kësaj rruge, Shqipëria do të hynte në

³⁹ S. Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri...*, f. 293.

⁴⁰ TNA, FO 371/ 7328. Heathcote-Smith për markezin Curzon të Kedleston, Durrës, 14 janar 1922; *po aty*, FO 371/ 7328. Heathcote-Smith për Foreign Office, Durrës, 26 janar 1922.

⁴¹ *Po aty*, FO 371/ 7328. Notë e ministrit “ad interim” të Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Spiro G. Koleka, drejtuar përfaqësisë diplomatike britanike në Durrës, Tiranë, 12 janar 1922.

⁴² P. Teli (Dibra), *Shqipëria dhe diplomacia angleze...*, f. 200.

rrugën e qytetërimit. Qeveria parashikonte që në Ministrinë e Financave dhe të Arsimit të caktonte organizatorë anglezë dhe amerikanë, ndërsa për ministrinë e tjera të emëronte shtetas austriakë.⁴³

Konsulli britanik Heathcote-Smith njoftoi Foreign Office për kërkesën shqiptare. Qeveria shqiptare merrte përsipër t'i jepte këshilltarit britanik kompetenca të plota. Përfaqësuesi i qeverisë shqiptare në Paris, ishte autorizuar që ta diskutonte këtë çështje në mënyrë të detajuar në Londër. Heathcote-Smith kishte zhvilluar një bisedë me kryeministrin shqiptar, i cili i kishte shpjeguar se kompetencat e plota nuk përfshinin hartimin e buxhetit të shtetit shqiptar dhe se qeveria shqiptare do të mundej në çdo kohë, ta refuzonte ekspertin dhe të merrte specialistë të tjerë.⁴⁴

Diplomati britanik Heathcote-Smith i dërgoi qeverisë së tij një raport të detajuar në lidhje me kërkesën e qeverisë shqiptare. A shkruante se kryeministri Xhafer Ypi dhe anëtarët e tjerë të qeverisë mendonin se Këshilli i Ministrave kishte autoritetin e duhur për të arritur një marrëveshje për angazhimin dhe përcaktimin e kompetencave të organizatorëve të huaj, pa ia paraqitur këtë çështje Parlamentit Shqiptar. Qeveria shqiptare kishte në plan që, krahas këshilltarit financiar, të ftonte organizatorë të tjerë të huaj me kompetenca të plota për Ministrinë e Luftës, të Drejtësisë, të Punëve Publike si dhe për xhandarmërinë. Deri në këtë moment, kjo qeveri nuk ishte marrë vendim se nga cilat vende do të vinin këta organizatorë të huaj; nuk kishte përcaktuar se sa do të ishin pagat e tyre; mbetej e paqartë se cila do të ishte hapësira e veprimtarisë së këtyre organizatorëve si dhe kushte të tjera që pritej të përfshiheshin në kontratat e qeverisë me këshilltarët e huaj. Madje, për këto çështje, kryeministri Xh. Ypi i kishte pohuar diplomatit Heathcote-Smith se qeveria shqiptare kishte vendosur të mbështetej në këshillat e qeverisë britanike. Kryeministri shqiptar kishte sugjeruar që nëse mendohej e përshtatshme, shefi i organizatorëve të huaj, do të duhej të shoqërohej nga një ose dy asistentë, të cilët do të paguheshin nga qeveria shqiptare. Megjithatë, gjatë periudhës së zbatimit të kontratës së tyre, qeveria shqiptare mendonte se ekspertët e huaj do të duhej të vepronin nga të

⁴³ “Shenja gazmore”, *Koha*, nr. 70, Korçë, 25 shkurt 1922, f. 2.

⁴⁴ *TNA*, FO 371/ 7328. Telegram i Heathcote-Smith për Foreign Office, Durrës, 14 janar 1922; P. Teli (Dibra), *Shqipëria dhe diplomacia angleze...*, f. 200; *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, vëll. II (1920-1924), botim i Institutit të Historisë, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë: Kristalina-KH, 2019, f. 213.

gjitha pikëpamjet, njësoj si të ishin zyrtarë të administratës së shtetit shqiptar.⁴⁵

Në lidhje me procesin e negocimit për marrjen e këshilltarit financiar, qeveria shqiptare kishte në plan të ngarkonte Mid'hat Bej Frashërin, i cili ishte përfaqësuesi i Shqipërisë në Paris. Atij pritej t'i jepeshin kompetencat e duhura për zhvillimin e negociatave derisa të emërohej përfaqësuesi i qeverisë shqiptare në Londër, gjë që shpresohej të realizohej brenda dy muajve.

Në përgjigje të pyetjeve të Heathcote-Smith, Xhafer Ypi i kishte shpjeguar verbalisht se në "kompetencat e plota" që do t'i jepeshin organizatorit të financave përfshiheshin: 1. Kontrolli i plotë administrativ i personelit dhe organizimi i Ministrisë së Financave; 2. Të drejtën dhe detyrën për të dhënë mendimin e specializuar për kushtet e koncesioneve të propozuara; 3. Të drejtën dhe detyrën për të kërkuar dhe propozuar burime të reja të ardhurash për qeverinë shqiptare; 4. Të drejtën dhe detyrën për të ndihmuar në hartimin e buxhetit të shtetit.

Megjithatë, këshilltari financiar nuk do të kishte të drejtën për të këmbëngulur në hartimin përfundimtar të buxhetit të shtetit; dhe as të drejtën për ndarjen e të ardhurave midis shërbimeve të ndryshme. Madje, këshilltari financiar nuk kishte të drejtë të ndërhynte edhe nëse tejkaloheshin buxheti i përgjithshëm i shtetit nga ana e qeverisë.

Diplomati britanik kishte kërkuar të informohej në lidhje me qëndrimin që do të mbahej nga shteti shqiptar, nëse qeveria kundërshtonte pikëpamjet e organizatorit financiar. Kryeministri shqiptar ishte përgjigjur se kjo çështje përbënte me të vërtetë një problem. Shteti shqiptar ishte i vendosur të mos pranonte që t'u delegonte të tjerëve, të drejtat e tij sovranë në fushën e financës. Ai kishte shtuar se, nëse organizatori financiar nuk do ta miratonte politikën e ndjekur nga qeveria shqiptare, ai do të qëndronte në krye të kësaj detyre, i bindur dhe me ndërgjegjen e pastër se, ai e kishte kryer detyrën që i takonte, duke ia përcjellë qeverisë, mendimet e tij të kundërta me të cilat nuk binte në pajtim me të. Kryeministri shqiptar besonte se shpresat për zhvillimin ekonomik dhe financiar të Shqipërisë mund të rriteshin, nëse nga kombinimi ideal i rrethanave, do të mund të zgjidhej një organizator i

⁴⁵ TNA, FO 371/7328. Heathcote-Smith për markezin Curzon të Kedleston, Durrës, 14 janar 1922; *po aty*, FO 371/7328. Heathcote-Smith për Foreign Office, Durrës, 26 janar 1922.

aftë britanik, i cili përmes shkathtësisë dhe forcës së personalitetit, do të arrinte të bënte për vete edhe kundërshtarët e tij nga radhët e qeverisë dhe përmes argumenteve të shëndosha, ata do t'i pranonin pikëpamjet e organizatorit financiar.

Ahmet Zogu i kishte paraqitur diplomatit britanik një ilustrim, për të shpjeguar konceptin e tij për kompetencat relative që duhej të kishin organizatorët e huaj. Ai ishte shprehur se, në rast të një konflikti të mundshëm midis organizatorit dhe ministrisë së linjës, çështja për të cilin organizatori i huaj kishte mendime të kundërta me qeverinë, do të duhej të dërgohej për shqyrtim në parlament. Sipas këndvështrimit të A. Zogut, në Shqipëri duhej të kishte vetëm një politikë, ajo e zhvillimit ekonomik dhe arsimor të vendit dhe se çdo qeveri duhej të merrte pushtetin, pa i shkaktuar probleme vendit. Ai ishte i bindur se në Shqipëri kishte disa politikanë, të cilët për të siguruar ndonjë post në qeveri, ishin gjithnjë të gatshëm të kombinonin veprimet e “të jashtëmëve” [përfaqësuesve të opozitës] me qëndrimet e organizatorit të huaj, kundër “të brendshëmëve” [përfaqësuesve të qeverisë]. Në një konflikt të mundshëm të qeverisë me organizatorin, grupimi i politikanëve të opozitës mund të bashkoheshin në “mbështetje” të tij dhe të votonin së bashku kundër qeverisë, duke e rrëzuar atë. Në kushtet kur organizatori mund të siguronte mbështetje nga njëri apo tjetri krah politik, ai do të ishte gjithmonë i sigurtë për fitoren e tij në mosmarrëveshjet që mund të lindnin me anëtarët e qeverisë. Për këtë arsye, organizatori i huaj nuk mund të kishte një status special, pasi kjo mund të rrezikonte stabilitetin e brendshëm politik të Shqipërisë.

Xhafer Ypi mendonte se sapo qeveria shqiptare të kishte një organizator britanik në Ministrinë e Financave, për Shqipërinë do të ishte relativisht më e lehtë që të negocionte për sigurimin e një huaje nga ana e Fuqive të Mëdha apo nga ndonjë konsorcium i madh evropian.⁴⁶ Ai ishte optimist se, prania e një organizatori financiar britanik me kompetenca të plota do të përbënte një lloj karremi për të tërhequr kapitalistë të fuqishëm në këtë vend. Diplomati britanik e kundërshtoi këtë mendim. Ai theksoi se sigurimi i një kredie nuk do të lehtësohej nga prania e një zyrtari të tillë, nëse organizatori nuk ishte në pozicionin që të garantonte dhënien e huas së parashikuar. Për të realizuar këtë qëllim, këshilltari

⁴⁶ *Po aty*, FO 371/ 7328. Heathcote-Smith për markezin Curzon të Kedleston, Durrës, 14 janar 1922; *Po aty*, FO 371/ 7328. Heathcote-Smith për Foreign Office, Durrës, 26 janar 1922.

financiar duhej të ishte plotësisht i kënaqur me mënyrën e menaxhimit të financave nga ana e Shqipërisë dhe se asnjëherë qeveria shqiptare nuk duhej të merrte vendime, që preknin financat e shtetit shqiptar, pa pëlqimin e këshilltarit financiar. Në përfundim, kryeministri shqiptar i kërkoi diplomatit britanik që të siguronte qeverinë e tij se cilido të ishte synimi i Fuqive për organizatorin, qeveria shqiptare do të udhëhiqej nga synimi dhe vullneti i saj i mirë.⁴⁷

Raportit të diplomatit britanik Heathcote-Smith, në lidhje me çështjen e këshilltarit financiar britanik për Shqipërinë, në Foreign Office i vunë shënimin “No distribution” (Të mos shpërndahet). Me sa duket diplomatët britanikë i druheshin kritikave në parlament dhe në shtypin anglez për refuzimin e kësaj kërkesë, prandaj u përpoqën që ajo të mbetej sa më rezervate.⁴⁸

Funksionarët më të lartë të diplomacisë britanike shfaqën menjëherë një qëndrim unik kundërshtues ndaj këtij propozimi. Arsyen e sqaronte shkurt J. Troutbeck, nëpunës i Departamentit Qendror (Central Department) në Foreign Office. Ai shprehej se kjo kërkesë ishte disi e turbullt, sepse pritej që italianët nuk do ta mirëprisnin këtë propozim.⁴⁹

Gjatë diskutimeve që u zhvilluan në Foreign Office, Harold Nicolson, funksionar në Departamentin Qendror (Central Department) u shpreh krejtësisht kundër propozimit të paraqitur, për caktimin e një këshilltari financiar britanik për Shqipërinë. Në këndvështrimin e tij, kërkesa e qeverisë shqiptare vinte për shkak të mbështetjes që i dha qeveria britanike Shqipërisë, kundër ndërhyrjes ushtarake të Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene në brendësi të territorit të Shqipërisë. Nicolson sqaronte se, ky qëndrim u mor për shkak se shteti jugosllav “po sillej në mënyrë të neveritshme”, duke mbajtur parasysh faktin se Italia nuk do ta lejonte këtë mënyrë sjelljeje të shtetit serb dhe, po ta merrte kjo fuqi nismën e veprimit, mund të rrezikohej paqja në Evropë. Ai theksonte se “propozimi për këshilltar financiar, është një teh i hollë i një kame që të çon drejt grindjes dhe, nëse mbërthehem pas këtij propozimi, ne nuk do të përfitojmë asgjë, veçse do të humbasim mjaft kohë dhe durim”. Nicolson shprehej se nuk kishte pasur ndonjëherë simpati për Shqipërinë dhe me sa kuptonte, shqiptarët dëshironin shumë që Britania e Madhe të

⁴⁷ *Po aty*, FO 371/ 7328. Heathcote-Smith për markezin Curzon të Kedleston, Durrës, 14 janar 1922.

⁴⁸ P. Teli (Dibra), *Shqipëria dhe diplomacia angleze...*, f. 202.

⁴⁹ *Po aty*.

përplasej me Italinë, në mënyrë që Shqipëria të mos dilte krejtësisht jashtë sferës së interesave britanike. Prandaj, ai theksonte se “ne nuk duhet të jemi aq naivë sa të bëjmë gjëra të këtij lloji. Shqipëria ka të ngjarë të mbetet një shprehje gjeografike për një periudhë të konsiderueshme, ndonëse vendi dhe njerëzit atje kanë një lloj sharmi, i cili na tërheq, duhet të na bëjë të gjithë ne më të kujdesshëm që të mos marrim përgjegjësi, të cilat ne i dimë mirë se do të jenë të rrezikshme”.⁵⁰ Krahës këtij mendimi, Nicolson mendonte se një veprim i tillë do të shkaktonte një acarim jo vetëm në Itali, por edhe në Francë, Jugosllavi e Greqi. Në përfundim, ai theksonte se, për arsytet e mësipërme, besonte se, “ne nuk do të duhej të priremi drejt një pozite të papërshtatshme, për të kthyer Shqipërinë (e cila është një kallam mjaft i thyer) kundër Italisë, ndërkohë që kjo e fundit megjithë gabimet e saj, së paku është shtet”. Prandaj, ai kërkonte që Heathcote-Smith të udhëzohej që të tërhiqej nga ky propozim, pa pritur udhëzimet e qeverisë britanike.⁵¹

Pra, qeveria britanike nuk donte të merrte përgjegjësi për Shqipërinë për këto arsye:

Së pari, propozimi shqiptar paraqiste rreziqe, pasi mund të shkaktonte reagimin e ashpër të Italisë, Francës dhe Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene.

Së dyti, meqenëse Shqipëria nuk ishte përparësi e interesave britanike, prania e këshilltarit financiar britanik në këtë vend ballkanik, nuk do të sillte ndonjë përfitim të madh për Britaninë e Madhe.

Së treti, në kushtet kur nuk dihej ecuria e shtetit shqiptar në të ardhmen, përpjekjet e diplomacisë britanike mund të shoqëroheshin me humbje kohe dhe energjish;

Së katërti, qeveria britanike mund të ndeshte vështirësi mjaft të mëdha për gjetjen e një njeriu të përshtatshëm për këtë punë. Për arsytet e lartpërmendura, qeveria britanike udhëzoi konsullin Heathcote-Smith të refuzonte sa më shpejt propozimin e paraqitur nga qeveria shqiptare.⁵² Në telegramin që Foreign Office i drejtonte Heathcote-Smith thuhej se, duhet

⁵⁰ TNA, FO 371/ 7328. Mendime të Harold Nicolson të pasqyruara në protokollin e Foreign Office, FO, 16 janar 1922; P. Teli (Dibra), *Shqipëria dhe diplomacia angleze...*, f. 202.

⁵¹ TNA, FO 371/ 7328. Mendime të Harold Nicolson të pasqyruara në protokollin e Foreign Office, FO, 16 janar 1922.

⁵² *Po aty*; FO 371/ 7328. Mendime të Sekretarit britanik të Shtetit, lordit Curzon të Kedleston të pasqyruara në protokollin e Foreign Office, FO, 16 janar 1922.

ta shkuraioni si propozim, kërkesën e qeverisë shqiptare për një ekspert financiar britanik.⁵³

Sipas praktikës që ndiqej nga Foreign Office, kur asaj i paraqiteshin çështje që dilnin jashtë sferës politike e diplomatike, përpara se të merrte një mendim përfundimtar, ky dikaster zakonisht merrte në konsideratë mendimin paraprak të institucioneve përkatëse britanike. Për çështjen e këshilltarit financiar të Shqipërisë, u mendua se motivet politike i tejkalonin interesat ekonomike të shtetit britanik. Prandaj, Harold Nicolson shprehej se për këtë rast, “ne nuk do të duhej të pyesim Thesarin (Treasure of Chambers)*, për pikëpamjen e këtij institucioni, por thjesht duhej t’i dërgohet një kopje atij, ku t’i thuhet se ne jemi kundër çdo lloj sugjerimi të kësaj natyre”.⁵⁴

Sidney P. Waterlow që mbante detyrën e drejtorit të Divizionit për Çështjet e Jashtme në Departamentin e Tregtisë së Jashtme (The Department of Overseas Trade), i drejtoi një letër Nënsekretarit të Thesarit të Britanisë së Madhe, sir Basil Blackett, ku i shkruante se, lidhur me letrën e datës 20 të këtij muaji, për çështjen e organizimit të financave të Shqipërisë, ishte udhëzuar nga Sekretari i Shtetit, markezi Curzon i Kedleston, për t’i përcjellë një kopje të depeshës së konsullit në detyrë të Britanisë së Madhe në Durrës. Në letrën shoqëruese të Curzon thuhej: “Po theksoj si informacion paraprak për Lordët Komisionerë të Thesarit të Madhërisë së Tij se, Sekretari i Shtetit për Punët e Jashtme është kundër propozimit të paraqitur në këtë depeshë.”⁵⁵ Siç shihet, informacioni i mësipërm iu kalua Thesarit britanik në një mënyrë krejtësisht formale, ku shfaqej qartë mendimi i Foreign Office se nuk e favorizonte këtë propozim për motive politike.⁵⁶

⁵³ *Po aty*, FO 371/ 7328. Telegram i Foreign Office për Heathcote-Smith në Durrës, FO, 18 janar 1922.

* “Thesari i Madhërisë së Tij”, ndonjëherë emërtohet edhe si “Dhoma e Thesarit” (The Treasure of Chambers), apo në mënyrë më informale “Thesari”, është një departament i qeverisë britanike, përgjegjës për zhvillimin dhe zbatimin e politikës qeveritare, të financave publike dhe politikës ekonomike. Warren C. Hollister, “The Origins of the English Treasury”, *The English Historical Review*, vol. XCIII, Issue CCCLXVII, Oxford University Press: April 1978, f. 262–275.

⁵⁴ *TNA*, FO 371/ 7328. Mendime të Harold Nicolson të pasqyruara në protokollin e Foreign Office, FO, 26 janar 1922.

⁵⁵ *Po aty*, FO 371/ 7328. S. P. Waterlow për sir B. Backett, Nënsekretari i Thesarit të Britanisë së Madhe, FO, 31 janar 1922.

⁵⁶ P. Teli (Dibra), *Shqipëria dhe diplomacia angleze...*, f. 201.

Ndërkohë, kërkesa e Shqipërisë për sigurimin e një këshilltari financiar britanik kishte shqetësuar qeverinë italiane. Për këtë arsye, ambasadori italian në Londër kishte pyetur kohët e fundit në Foreign Office, nëse qeveria britanike kishte ndërmend të dërgonte një këshilltar financiar britanik në Shqipëri. H. Nicolson e kishte informuar diplomatin italian se, qeveria britanike kishte marrë njoftim lidhur me këtë propozim, por ajo e kishte shkurajuar këtë kërkesë. Pavarësisht, përgjigjes së përfaqësuesit britanik se, Britania e Madhe nuk ishte e interesuar për emërimin e një këshilltari financiar britanik në Shqipëri, ambasadori italian nuk kishte harruar pa shprehur mendimin se, nuk mund të imagjinohej se çfarë përshtypje negative do të krijonte në Itali, një emërim i tillë.⁵⁷

Kandidatura e shtetasit britanik George Young për detyrën e këshilltarit financiar të Shqipërisë dhe reagimi i qeverisë britanike

Sipas udhëzimeve të qeverisë shqiptare, ministri i Shqipërisë në Londër, Mehmet Konica, u kërkoi ndihmë rretheve filoshqiptare në Britaninë e Madhe, për gjetjen e një kandidature të përshtatshme që të merrte detyrën e këshilltarit financiar të Shqipërisë. Me sugjerimin e këtyre rretheve, diplomati shqiptar vendosi kontakt të drejtpërdrejtë me ish diplomatin britanik George Young, të cilit i paraqiti ftesën për të marrë detyrën e këshilltarit të financave të Shqipërisë.⁵⁸

Më 1 prill 1922, George Young, iu drejtua drejtpërdrejtë me një letër Nënsekretarit të Përherëshëm britanik të Shtetit për Punët e Jashtme, sir Eyre Crowe, përmes së cilës e informonte atë se, ai ishte ftuar nga qeveria shqiptare për të pranuar detyrën e këshilltarit financiar për Shqipërinë. Ai i bënte të ditur Nënsekretarit të Shtetit se, kishte dëshirë ta pranonte këtë ofertë. Por, në të njëjtën kohë, Young theksonte se, ndershmërisht, nuk mund ta pranonte këtë detyrë në qoftë se nuk do të ishte i sigurtë se, ai do të punonte në kushte miqësore me ish kolegët e tij

⁵⁷ TNA, FO 371/ 7328. Mendime të Harold Nicolson për çështjen e këshilltarit financiar britanik të pasqyruara në protokollin e Foreign Office, FO, 30 janar 1922.

⁵⁸ P. Teli (Dibra), *Shqipëria dhe diplomacia angleze...*, f. 203.

të Foreign Office dhe se ai priste të kishte mbështetjen nga ky dikaster për emërimin e tij.⁵⁹

Kërkesa e G. Young për të marrë detyrën e këshilltarit financiar të Shqipërisë u shqyrtua seriozisht nga funksionarët dhe drejtuesit e Foreign Office. Për të krijuar një panoramë të qartë për kandidaturën e paraqitur, Harold Nicolson zhvilloi biseda me diplomatë të njohur dhe bëri kërkime në arkivin e Foreign Office. Ai fillimisht pati një konsultë me sir W. Tyrrell, i cili ishte një diplomat i shquar karriere. Tyrrell i kishte shprehur mendimin se pavarësisht talentit të padyshimtë që kishte G. Young në sektorin e industrisë, mungesa e gjykimit të ftohtë dhe e drejtpeshimit e bënin atë një kandidat të papërshtatshëm për çdo lloj detyre me përgjegjësi.

Më tej, H. Nicolson kreu verifikime edhe në arkivin e Sekretarisë Private të Foreign Office*, ku kishte gjetur një dosje të tërë për Georg Young gjatë periudhës që ishte në detyrë. Në përfundim të hulumtimeve të kryera, Nicolson kishte mësuar se në vitin 1915, G. Young ishte shkarkuar nga shërbimi diplomatik. Për t'u hakmarrë ndaj Foreign Office, ai kishte kritikuar publikisht administratën e shërbimit diplomatik, duke sulmuar veçanërisht zyrën e Sekretarisë Private. Madje, G. Young kishte botuar edhe një libër, në të cilin sulmonte ashpër institucionin dhe personalitetet e Foreign Office. Për sa më sipër, H. Nicolson informonte drejtuesit e Foreign Office se, Georg Young kishte qenë pjesë e shërbimit diplomatik britanik për 19 vite. Gjatë kësaj periudhe, ai kishte krijuar një reputacion negativ, si një person i palidhur me detyrën, jo besnik dhe i

⁵⁹ TNA, FO 371/ 7328. Letër e George Young për sir Eyre Crowe, Formosa Fishery, Cookham, Berks, 1 prill 1922.

* “Sekretaria Private e Sekretarit të Shtetit për Punët e Jashtme të qeverisë së Madhërisë së Tij ndodhet në ndërtesën kryesore të Foreign Office. Në fillim të shek. XIX, Sekretari i i Shtetit për Punët e Jashtme kishte një ose dy sekretarë privatë, të cilët shpeshherë ishin emërimet personale të drejtuesit të zyrës. Me rritjen e ndjeshme të kompleksitetit të çështjeve të politikës së jashtme britanike, numri i ekspertëve të zyrës private u rrit, me qëllim që të jepnin një mbështetje më të madhe politike dhe administrative. Nëpunësi civil kryesor në zyrën private u bë sekretari kryesor privat, i cili në ditët e sotme është shefi i një departamenti të vogël. Ky post është i rëndësishëm dhe zakonisht mbahet nga një zyrtar me përvojë në shërbimin diplomatik për një periudhë deri në dy vjet”. “Introduction”, in *Office-Holders in Modern Britain: Volume 2, Officials of the Secretaries of State 1660-1782*, ed. J. C. Sainty, London: 1973, f. 1-21; John Michael Lee, George William Jones, June Burnham, *At the centre of Whitehall: advising the Prime Minister and Cabinet*, Palgrave Macmillan: 1998, f. 42-44.

pavërtetë. Prandaj, ai arrinte në përfundimin se krahas motiveve politike, të cilat duhej të shtynin qeverinë britanike që të mos dëshironte në asnjë rast, emërimin e një këshilltari financiar britanik në Shqipëri, kishte të dhëna të tjera, të cilat provonin se George Young nuk mund të rekomandohej nga Foreign Office për çfarëdolloj punësimi në Shqipëri.⁶⁰

Kandidatura e G. Young nuk i kishte ngjallur ndonjë interes sir Eyre Crowe, Nënsekretarit të Përhershëm të Shtetit për Punët e Jashtme, pasi më herët, ky i fundit kishte qenë pjesë e sulmeve publike të këtij kandidati, përmes shkrimeve të tij. Prandaj, Nënsekretari i Shtetit ishte shprehur se qeveria britanike duhej të tërhiqej nga ideja e caktimit të një shtetasi të saj në detyrën e këshilltarit financiar në Shqipëri. Sipas tij, “më tepër se për shqetësimin në planin personal, që i kishin shkaktuar sulmet e G. Young, duhej të merrej parasysh fakti se në këtë periudhë qeveria britanike, nuk do të mund të siguronte një mbështetje të gjerë për një kandidaturë britanike”.⁶¹

Sekretari britanik i Shtetit, lordi Curzon, e shqyrtoi me kujdes çështjen e kandidaturës së George Young për detyrën e këshilltarit financiar të Shqipërisë. Ai arriti në përfundimin që për motive politike, nuk mund të zgjidhej një këshilltar britanik për këtë vend. Në këndvështrimin e tij, një emërim i tillë jo vetëm që do të ngrinte dyshime dhe pakënaqësi nga ana e fuqive të tjera, por kjo lëvizje politike, do të angazhonte përgjegjësinë e Britanisë së Madhe në Shqipëri në një masë të tillë, sa kjo do të shkaktonte shqetësim në vendet fqinje. Për këtë arsye, ai mendonte se “ne do të duhej të ndërmarrim hapat e duhur për të shkurajuar këtë propozim dhe për t’i treguar miqësisht qeverisë shqiptare se ne besojmë se ajo do të duhej të zgjidhte këshilltarin e saj nga ndonjë vend tjetër”. Përfundimisht, ai vendosi të refuzonte kërkesën e G. Young për të marrë këtë detyrë në Shqipëri. Lordi Curzon i shkruante atij se, “do të ishte krejt e pamundur për mua që të mbështes kandidaturën tuaj apo të premtoj bashkëpunimin me ju në kapacitetin e këshilltarit të qeverisë shqiptare”.⁶²

Deputeti dhe komandanti britanik, leutnant Hilton Young, i drejtoi një letër Sekretarit britanik të Shtetit, lordit Curzon, në të cilën shprehej

⁶⁰ TNA, FO 371/ 7328. Mendime të Harold Nicolson për “Z. George Young”, të pasqyruara në protokollin e Foreign Office, FO, 6 prill 1922.

⁶¹ Po aty.

⁶² Po aty, FO 371/7328. Letër e lordit Curzon për George Young M.V.O., FO, 5 prill 1922.

se vëllai i tij i madh ishte ftuar nga ministri i Shqipërisë për t'u bërë këshilltar financiar i qeverisë shqiptare. H. Young theksonte se ky post nuk ishte nga ato, të cilin shumë të tjerë do ta lakmonin dhe se “mua më duket se kjo detyrë është e vështirë”. Por megjë vëllai i tij “ishte një njeri aktiv me një shpirt aventurier dhe kishte kualifikimin e duhur për këtë punë”, mendonte se përmbushte kushtet për t'u caktuar në këtë detyrë.⁶³

Një ditë më vonë, Sekretari britanik i Shtetit iu përgjigj deputetit Hilton Young. Ai theksonte se “unë mund t'ju them se, dokumentet që gjenden në Foreign Office, qysh përpara se unë të merrja këtë detyrë, nuk më inkurajojnë që të mbështes propozimin që përmban letra juaj”. Gjithashtu, kreu i diplomacisë britanike shprehej se, pavarësisht mendimit mjaft vlerësues që keni për aftësitë e vëllait tuaj, emërimi i një këshilltari britanik në Shqipëri do të kishte pasoja fatkeqe nga pikëpamja ndërkombëtare. Në këto rrethana, “çështja më e fundit që ne do të dëshironim të bënim pikërisht tani, është ajo e negocimit të një këshilltari financiar britanik në Shqipëri, e cila do t'u jepte Fuqive të tjera përshtypjen se ne dëshirojmë të ushtrojmë apo të kemi një rol mbizotërues në këtë vend”.⁶⁴

Kur qeveria shqiptare pa se qeveria britanike nuk kishte ndërmend të emëronte një këshilltar financiar britanik, ajo vendosi të ndryshonte taktikë. Me sa duket, me sugjerimin e Komisionit Hetimor të Lidhjes së Kombeve të dërguar në Shqipëri, krahas kërkesës për shtyrjen e afatit të pranisë së Komisionit Hetimor në Shqipëri, qeveria shqiptare i kërkoi Këshillit të Lidhjes së Kombeve që ta zgjeronte mbështetjen e saj edhe në fushën ekonomike. Qeveria shqiptare kërkoi emërimin e ekspertëve të Lidhjes së Kombeve që të merreshin me çështjet ekonomike e financiare të Shqipërisë, të kryenin studime në terren dhe të bënin propozimet e duhura në lidhje me hapat që duhet të ndërmerreshin prej saj, për të nxitur hyrjen e kapitalit të huaj, i cili do të mundësonte zhvillimin e burimeve natyrore të vendit.⁶⁵

⁶³ *Po aty*, FO 371/7328. Letër e Hilton Young për lordin Curzon, House of Commons, 6 prill 1922.

⁶⁴ *Po aty*, FO 371/7328. Letër e lordit Curzon për komandantin lietnant E. Hilton Young, D.S.C., M.P., FO, 7 prill 1922.

⁶⁵ *Po aty*, FO 371/ 7328. Notë e Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve, E. Drummond, për anëtarët e Këshillit të Lidhjes së Kombeve, Gjenevë, 31 mars 1922, bashkëlidhur së cilës gjendet telegrami i Kryeministrit dhe ministrit “ad interim” të

S u m m a r y

THE DIFFICULT ECONOMIC AND FINANCIAL SITUATION OF ALBANIA AND THE EFFORTS OF THE ALBANIAN GOVERNMENT TO PROVIDE A BRITISH FINANCIAL ADVISOR (1921-1922)

This article reflects the endless difficulties faced by the leaders of the Albanian state in economic and financial terms in the early 1920s. In January 1922, the Albanian government asked the British government to support her in finding a capable financial advisor. The Albanian government undertook to give the British adviser full powers, such as: Full administrative control of staff and the organization of the Ministry of Finance; Giving a specialized opinion on the terms of the proposed concessions; Seek and propose new sources of revenue for the Albanian state budget; To assist the Albanian government in drafting the state budget. However, the financial advisor did not have the right to allocate funds to various ministries nor to block the drafting of the Albanian state's final budget.

The Minister of Albania in London, Mehmet Konica, invited the former British diplomat George Young to take the position of the financial advisor of Albania. Top Foreign Office officials expressed a unique opposition to this proposal. The British government rejected Albania's request to have a British financial adviser, for the following reasons: First, the Albanian proposal could provoke a backlash from Italy, France and the Serbo-Croatian-Slovenian Kingdom. Secondly, since Albania was not a priority of British interests, the presence of the British financial advisor in this Balkan country would not bring any great benefit to Great Britain. Third, in conditions when the future state of the Albanian state was not known, the efforts of British diplomacy could be associated with a waste of time and energy; Fourth, the British government could face considerable difficulties in finding a suitable man for this job.

